



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



RAPORT MONITORIMI

RAPORTIMI I OSHMA-ve GJATË FUASHATËS ZGJEDHORE

Zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale në komunat: Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan

Periudha e monitorimit 13 – 19 maj 2019 Prishtinë

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
II. BAZA LIGJORE.....	5
III. METODOLOGJIA DHE REALIZIMI.....	5
IV. GJETJET NGA MONITORIMI.....	7
V. SHKELJET E GJETURA DHE VEPRIMETE KPM-SË.....	7
Neni 1 QËLLIMI.....	8
Neni 2 FUSHËVEPRIMI.....	8
VI. ANKESAT.....	9
VII. HAPËSIRA E OFRUAR PËR SCP-të.....	9
OSHMA-të me mbulim tokësor nacional.....	9
OSHMA-të me mbulim tokësor lokal/regjional në Regjionin e Mitrovicës.....	10
OSHMA-të që operojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes.....	13
VIII. PERIUDHA E HESHTJES ZGJEDHORE.....	15
IX. SFIDAT DHE VËSHTIRËSITË GJATË MONITORIMIT TË PAJTUESHMËRISË SË TË LICENCUARVE TË KPM-SË.....	15
X. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	16

AKRONIMET E PËRDORURA NË RAPORT

KPM - Komisioni i Pavarur i Mediave

KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

DMA - Departamenti i Monitorimit dhe Analizës i KPM-së

SCP - Subjekt i Certifikuar Politik

OSHMA - Ofrues i Shërbimit Medial Audio-Vizuel

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), duke qenë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës¹ i cili vlen edhe për zgjedhjet lokale, ka bërë monitorimin e ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele (OSHMA) të cilat kanë mbuluar fushatën e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan në Republikën e Kosovës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)², për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, të cilat janë mbajtur më 19 maj 2019, ka certifikuar tri (3) subjekte të certifikuara politike (SCP): Partia Demokratike e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje dhe Srpska Lista.

Qëllim i monitorimit të bërë nga periudha 13 deri më 19 maj 2019, ishte vlerësimi i performancës së OSHMA-ve në pajtim me Kreun VIII të këtij Ligji, të titulluar “Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”. Ky raport është realizuar nga Departamenti i Monitorimit dhe Analizës (DMA) i Zyrës Ekzekutive, dhe prezanton të gjeturat nga monitorimi i OSHMA-ve gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore dhe periudhës së heshtjes zgjedhore deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve.

Në monitorim janë përfshirë nëntë (9) ofrues të shërbimeve mediale audio-vizuele, prej të cilëve:

- Tri (3) me mbulim tokësor nacional (RTK1, KTV dhe TV21);
- Tri (3) OSHMA me mbulim tokësor lokal/regjional të Regjionit të Mitrovicës (TV Mitrovica, TV Mir dhe TV Most);
- Një (1) OSHMA me mbulim tokësor regjional i Regjionit të Gjilanit (TV Puls); dhe
- Dy (2) OSHMA me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2 dhe TV Kiss).

Për shkak të problemeve teknike me sinjal në sistemin e monitorimit, nga TV Mir është kërkuar të ofrojë arkivin e programit të transmetuar gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Për shkak se ky subjekt nuk ka ofruar arkivin e programit, të dhënat për periudhën 13-17 maj 2019 mungojnë në këtë raport.

Gjatë procesit të monitorimit, në fokus ishin të gjitha format e prezantimit medial të fushatës zgjedhore si: edicionet e lajmeve, spotet politike, kronikat zgjedhore dhe intervistat e debatet e transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00.

Zyrtarët e Departamentit të Monitorimit dhe Analizës (DMA) gjatë periudhës monitoruese kanë vlerësuar : paanshmërinë në raportim, hapësirën e ofruar për SCP-të, gjuhën e përdorur dhe në përgjithësi pajtueshmërinë me Udhëzuesin për Zgjedhjet dhe aktet tjera nënligjore respektive të KPM-së.

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2544>

² <http://www.kqz-ks.org/lajmet/permbyllet-afati-per-aplikim-te-subjekteve-politike-per-certifikim-per-pjesemarrje-ne-zgjedhjet-e-jashtezakonshme-per-kryetar-ne-kater-komuna/>

Nga të gjeturat e monitorimit rezulton se përkundër disa përjashtimeve, prezantimi i fushatës për zgjedhjet e jashtëzakonshme nga OSHMA-të ishte kryesisht objektiv dhe i paanshëm, në pajtim me dispozitat për media në Ligjin për Zgjedhje dhe Kodin Etik për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio-Vizuele³.

II. BAZA LIGJORE

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet i cili përcakton në mënyrë specifike dispozitat për “Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”.

Për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun VIII të këtij Ligji, KPM ka përcjell tek të licencuarit Udhëzuesin, i cili në fakt është interpretim më i detajuar i dispozitave të Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhje.

Udhëzuesi përbëhet prej tre kapitujve:

- 1.KAPITULLI I – identifikimi i reklamimit politik;
- 2.KAPITULLI II – raportimi për hulumtimin e opinionit publik lidhur me zgjedhjet; dhe
- 3.KAPITULLI III – periudha e heshtjes zgjedhore.

Sipas nenit 53 të Ligjit për Zgjedhje, KPM siguron që të licencuarit mirëmbajnë ditarë për të regjistruar kohën e emetimit dhe ekspozimeve tjera në media, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilin SCP. Për këtë qëllim, KPM u ka dërguar të licencuarve edhe format e ditarëve me dhe pa pagesë si dhe udhëzuesin për mënyrën e plotësimit të tyre. Gjithashtu, KPM ka kërkuar nga OSHMA-të të njoftojnë nëse do të mbulojnë garën për balotazh.

III. METODOLOGJIA DHE REALIZIMI

Metodologjia e përdorur gjatë monitorimit të performancës së ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele, është bazuar në analiza sasiore dhe cilësore, me theks të veçantë në edicionet qendrore të lajmeve, kronikat zgjedhore, pikat reklamuese politike si dhe intervista e debate në përmbajtjet programore të transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00. Metodologjia e monitorimit ka konsistuar në regjistrimin e programeve, kategorizimin e tyre, si dhe matjet e kohës/hapësirës për second të dedikuar secilit SCP. Për këtë qëllim janë futur të dhëna në tabelat e dizajnuara paraprakisht, vlerësimi i prezantimit të fushatës nëse ka qenë pozitiv, negativ apo neutral, përpunimi dhe analiza e të dhënave të fituara dhe në fund hartimi i raportit final lidhur me mbulimin medial të fushatës zgjedhore. Nxjerrjen e këtyre të dhënave e mundësoi sistemi i monitorimit të cilin e posedon KPM, përmes të cilit bëhet pranimi, incizimi dhe arkivimi i programeve të transmetuara të OSHMA-ve.

³ <http://kpm-ks.org/materiale/dokument/1476189555.8908.pdf>

Matja e hapësirës së dedikuar SCP-ve është bërë duke llogaritur kohën në sekonda (në lajme, intervista, debate dhe kronika zgjedhore). Bazuar në këto llogaritje, janë dhënë tabelat për kohën e ofruar për kandidatët në sekonda dhe përqindje. Analizat janë bërë për të vlerësuar nëse:

- OSHMA-të kanë raportuar në mënyrë të drejtë dhe korrekte-raportimi objektiv dhe i paanshëm; OSHMA-të kanë ofruar mundësi për promovimin e platformave politike të SCP-ve/ kandidatëve në garë;
- OSHMA-të kanë ofruar qasje të njëjtë për SCP-të në debate/intervista, pyetje të njëjta, mundësi për replikë në emisione debatuese, renditje të aktiviteteve zgjedhore në lajme e kronika zgjedhore (renditja me rotacion duke mos favorizuar prezantimin e aktiviteteve të SCP-ve me renditje të njëjtë për çdo ditë të fushatës); dhe
- OSHMA-të kanë vepruar në pajtueshmëri me heshtjen zgjedhore dhe dispozitat tjera të Ligjit për Zgjedhje.

Po ashtu, gjatë analizës është bërë edhe vlerësimi për mënyrën e prezantimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe standardet profesionale të gazetarisë (nëse ka pasur nxitje të urrejtjes, gjuhë të papërshtatshme, denigruese, fyerje, shpifje apo shkelje të dispozitave tjera të dhëna në Kodin e Etikës).

Kohëzgjatja dhe të gjeturat në këtë raport janë të periudhës së monitorimit nga data 13 deri më 19 maj 2019.

Në monitorim janë përfshirë nëntë (9) ofrues të shërbimeve mediale audio-vizuele, si mostra më reprezentative për natyrën e këtij aktiviteti, prej të cilëve:

- Tri (3) me mbulim tokësor nacional (RTK1, KTV dhe TV21);
- Tri (3) OSHMA me mbulim tokësor lokal/regjional të Regjionit të Mitrovicës (TV Mitrovica dhe TV Most);
- Një (1) OSHMA me mbulim tokësor regjional i Regjionit të Gjilanit (TV Puls); dhe
- Dy (2) OSHMA me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2 dhe TV Kiss).

TV Mir nuk është monitoruar në periudhën 13 deri më 17 maj 2019 në mungesë të arkivës së programit të transmetuar këtë periudhë.

IV. GJETJET NGA MONITORIMI

Gjatë fushatës zgjedhore, OSHMA-të kanë vepruar kryesisht në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, respektivisht Kreun VIII-të këtij Ligji.

Nga nëntë (9) subjekte të monitoruara, vetëm katër (4) kanë mbuluar aktivitetet e subjekteve politike të certifikuara gjatë periudhës zgjedhore (RTK1, TV Most, TV Puls dhe TV Kiss), përmes hapësirës së dhënë në edicione të lajmeve. Gjatë kësaj periudhe, nuk janë transmetuar spote politike me apo pagesë, me përjashtim të TV Most në të cilin janë transmetuar spote politike si dhe emisione të sponsorizuara nga subjekti Srpska Lista, si dhe TV Puls në të cilin janë transmetuar spote politike të SCP Srpska Lista. Po ashtu, nga monitorimi është vërejtur se gjatë periudhës së fushatës zgjedhore nuk janë transmetuar debate televizive me kandidatët garues, përveç programeve debatuase dhe intervistave të zhvilluara në TV Most me kandidatë të SCP Srpska Lista.

Ndërsa, gjatë ditës së votimit, në përgjithësi OSHMA-të kanë raportuar rreth mbarëvajtjes së procesit zgjedhor në katër (4) komunat në të cilat janë mbajtur zgjedhjet për kryetar, me përjashtim të TV Most, në të cilin janë transmetuar përmbajtje në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhje sa i përket heshtjes zgjedhore, duke transmetuar deklarata të një kandidati për kryetar dhe mbështetësve politik të SCP Srpska Lista nga Serbia që bëjnë thirrje për mbështetje të këtij subjekti.

Raportimi i OSHMA-ve gjatë mbulimit të fushatës ishte kryesisht neutral dhe gjuha e përdorur gjatë kësaj fushate ka qenë kryesisht në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale, me përjashtim të disa rasteve në TV Most dhe TV Puls, në të cilat është vërejtur se ka pasur përmbajtje të gjuhës së urrejtjes dhe shprehjeve në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në Kodin e Etikës.

Nga monitorimi është vërejtur se nga OSHMA-të që kanë mbuluar aktivitetet e SCP-ve, RTK1 ka mbuluar aktivitetet e SCP-ve: PDK dhe LVV, ndërsa, OSHMA-të të cilat transmetojnë në gjuhën serbe (TV Most dhe TV Puls) kanë transmetuar vetëm aktivitetet e SCP-së Srpska Lista nga radhët e komunitetit serb.

Vlen të përmendet fakti se gjatë periudhës zgjedhore nuk ka pasur transmetim të spoteve politike me prezencë të fëmijëve.

V. SHKELJET E GJETURA DHE VEPRIMETE KPM-SË

Nga monitorimi i OSHMA-ve që kanë mbuluar fushatën zgjedhore është vërejtur se OSHMA-të kanë vepruar në pajtim me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje dhe Kodin e Etikës për Shërbimet Mediale Audiovizuale, me përjashtim të TV Most.

Shkeljet e evidentuara kanë të bëjnë me:

- Shkeljen e periudhës së heshtjes zgjedhore; dhe
- Gjuhën e përdorur në përmbajtje programore.

Sipas nenit 52.1 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhje përcaktohet se: “Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon 24 orë para hapjes së vendvotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendvotimeve”.

Sipas Kodit të Etikës për Shërbimet Mediale Audiovizuale, përkatësisht qëllimit dhe fushëveprimit të këtij Kodi, parashihet që:

Neni 1 QËLLIMI

“Kodi i Etikës ka për qëllim përcaktimin e rregullave të etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike; në pajtim me parimet etike, standardet e pranuar ndërkombëtarisht dhe respektin ndaj diversitetit të trashëgimisë etnike, kulturore dhe fetare në Republikën e Kosovës; për interesa të sigurisë kombëtare, të integritetit territorial dhe të sigurisë publike; për parandalimin e trazirave dhe të krimit; për mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të njeriut; për mbrojtjen e shëndetit dhe të moralit, për mbrojtjen e fëmijëve, për parandalimin e zbulimit të informatave të dhëna në besim dhe për ruajtjen e autoritetit dhe paanësisë”.

Neni 2 FUSHËVEPRIMI

“Dispozitat e këtij Kodi zbatohen ndaj të gjithë Ofruesve të Shërbimeve Mediale (OSHM), të licencuar nga KPM, për të garantuar lirinë e shprehjes, e cila përfshinë të drejtën e shprehjes për dhënien dhe marrjen e informacioneve, mendimeve dhe porosive të tjera pa u penguar dhe duke respektuar parimet e Kushtetutës së Republikës Kosovës, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

Ndërsa neni 4 i këtij Kodi, respektivisht paragrafi 3, përcakton që:

“Në programet e drejtpërdrejta (debate/intervista etj), është obligim i OSHM-së që të ndërmarrë veprimet e duhura për evitimin e përdorimit të gjuhës vulgare ose ofenduese nga ana e pjesëmarrësve”.

Sa i përket përmbajtjeve që përmbajnë elemente të nxitjes së urrejtjes, sipas nenit 5 të këtij Kodi parashihet që:

“1. OSHM-të nuk duhet të nxisin ose promovojnë, qëllimisht ose në mënyrë indirekte, cilëndo nga format e diskriminimit dhe të jo tolerancës dhe nuk duhet të transmetojnë asnjë material që

njolllosë një grup etnik apo fetar, apo që nënkupton se një grup etnik apo fetarë është përgjegjës për aktivitete kriminale”.

“3. OSHM-të gjatë transmetimit të përmbajtjes nuk do të lejojnë përdorimin e shprehjeve gjuhësore denigruese, me qëllim të lëndimit dhe kërcënimit të një individi apo grupi në bazë të përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, gjendjes martesore, moshës apo paaftësisë fizike ose mendore”.

“5. OSHM-të nuk duhet të transmetojnë përmbajtje programore që nxisin urrejtjen dhe pabarazinë dhe që mund të rezultojnë me veprime kriminale ose të dhunshme kundër një individi apo grupi”.

“6. OSHM-të nuk duhet të transmetojnë përmbajtje programore që nxisin urrejtjen mbi bazat e përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, gjendjes martesore, orientimit seksual, moshës, paaftësisë fizike apo mendore, pavarësisht nga situata apo rrethanat”.

VI. ANKESAT


Gjatë periudhës së zgjedhjeve lokale të jashtëzakonshme, KPM nuk ka pranuar asnjë ankesë.

VII. HAPËSIRA E OFRUAR PËR SCP-të

Të dhënat në tabelat më poshtë, lidhur me hapësirën e ofruar për SCP-të nga data 13 deri më 17 maj 2019, janë vetëm për periudhën kohore nga ora 16:00-24:00 gjatë së cilës është bërë monitorimi.

OSHMA-të me mbulim tokësor nacional

RTK1 - Gjatë periudhës monitoruese, sa i përket hapësirës së përgjithshme të SCP-ve, RTK1 ka ofruar këtë mbulueshmëri në edicione të lajmeve: PDK 86.43% dhe LVV 13.57%, dhe atë vetëm kandidatëve pjesëmarrës për Komunën e Mitrovicës së Veriut. Ndërsa, gjatë kësaj periudhe nuk është ofruar hapësirë përmes spoteve politike, debateve apo programeve tjera.



Hapësira në edicionet e lajmeve		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
PDK	446	86.43
LVV	70	13.57
Total	516	100


TV 21 dhe KTV - Në periudhën e zgjedhjeve, këto subjekte nuk kanë mbuluar aktivitetet e fushatës zgjedhore të kandidatëve garues.

OSHMA-të me mbulim tokësor lokal/regjional në Regjionin e Mitrovicës

TV MITROVICA – Në bazë të monitorimit është vërejtur se kjo OSHMA nuk ka përcjell aktivitetet e fushatës zgjedhore të kandidatëve pjesëmarrës në zgjedhje lokale.

TV MOST - Sa i përket hapësirës së ofruar në edicione të lajmeve dhe programeve tjera, ky subjekt ka ofruar hapësirë vetëm për SPC Srpska Lista, duke mbuluar aktivitetet e këtij subjekti në katër komunat në të cilat janë mbajtur zgjedhjet.


Hapësira në edicionet e lajmeve - OSHMA TV MOST



Hapësira në edicionet e lajmeve

SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
SL	5091	100.00
Total	5091	100

Hapësira në debate/intervista - OSHMA TV MOST



Hapësira në debate/intervista		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
SL	13169	100.00
Total	13169	100


Po ashtu, në bazë të monitorimit të edicioneve të lajmeve, janë transmetuar deklarata, përkatësisht thirrje për mbështetje të subjektit SRPSKA LISTA nga ana e përfaqësuesve politikë nga Serbia, A.Vuqiq, A.Brnbabiq dhe M.Gjuriq.

Gjatë periudhës zgjedhore, ky subjekt ka transmetuar spote politike vetëm të SCP Srpska Lista me pagesë, ndërsa janë transmetuar shpallje përmes së cilës ky subjekt ka bërë të ditur se TV Most do të ofrojë termine pa pagesë për kandidatët garues.

Sa i përket gjuhës së përdorur, është vërejtur se në disa raste janë transmetuar përmbajtje në të cilat ka pasur gjuhë të urrejtjes dhe përmbajtje që cenojnë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin e vendit, nga ana e moderatorëve të këtij televizioni, mysafirëve në programe si dhe në intervista të zhvilluar me qytetarë në këto komuna.

TV MIR – Ky subjekt, pas kërkesës nga KPM, nuk ka ofruar arkivën e programit të transmetuar gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe të dhënat lidhur me periudhën e fushatës zgjedhore mungojnë në këtë raport.

TV PULS - Sa i përket hapësirës së ofruar në edicione të lajmeve, ky subjekt ka ofruar hapësirë vetëm për SCP Srpska Lista.



Hapësira në edicionet e lajmeve		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
SL	826	100.00
Total	826	100

Është vërejtur se gjatë emisioneve të lajmeve janë transmetuar edhe termine me pagesë të këtij subjekti politik.

Ndërsa gjatë periudhës së fushatës, nuk janë transmetuar programe tjera që lidhen me aktivitet zgjedhor si: spote politike, debate apo programe tjera.

Sa i përket gjuhës së përdorur, është vërejtur se në disa raste vendit i referohen me emërtimin “Kosovo i Metohija” nga ana e këtij subjekti, ndërsa në një rast gjatë transmetimit të aktivitetit politik të SCP Srpska Lista në lajmeve, nga zyrtari i këtij subjekti gjatë fushatës përdoret termi “siptarski narod”.

OSHMA-të që operojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes

RTK2 – në bazë të monitorimit, është vërejtur se ky subjekt nuk ka përcjell aktivitetet e fushatës zgjedhore të kandidatëve garues, por vetëm ka raportuar për këto zgjedhje, ku dhënë informacione rreth këtij procesi si dhe janë transmetuar spote informuese të KQZ-së.

TV KISS – Gjatë periudhës monitoruese, sa i përket hapësirës së përgjithshme të SCP-ve, ky subjekt ka ofruar mbulueshmëri në edicione të lajmeve vetëm për SCP Srpska Lista.



Hapësira në edicionet e lajmeve		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
SL	391	100.00
Total	391	100

VIII. PERIUDHA E HESHTJES ZGJEDHORE

Gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, OSHMA-të kanë raportuar kryesisht në mënyrë korrekte, në pajtueshmëri me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje si dhe Kodin e Etikës për OSHMA-të.

OSHMA-të: RTK1, TV21, KTV, TV Mitrovica, TV Mir, TV Puls, RTK2, TV Kiss, kanë raportuar në përgjithësi në mënyrë të drejtë dhe të paanshme për ecurinë e mbarëvajtjes së zgjedhjeve.

Ndërsa, gjatë ditës së votimit në TV Most janë transmetuar material që i takon aktivitetit zgjedhor, në këtë rast të SCP Srpska Lista, si deklarata e kandidatit për Kryetar të Leposaviqit, M. Todiç, si dhe përfaqësuesit politik nga Serbia, M. Gjuriç, që bëjnë thirrje, në mes tjerash për mbështetje të këtij subjekti.

IX. SFIDAT DHE VËSHTIRËSITË GJATË MONITORIMIT TË PAJTUESHMËRISË SË TË LICENCUARVE TË KPM-SË

KPM ka të licencuar: 83 radio, 20 televizione si dhe 51 OSHMA që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes. Për shkak të vëllimit të madh të punëve dhe numrit të vogël të stafit monitorues, KPM ka monitoruar tri (3) TV-të me mbulim tokësor nacional, tri (3) TV-të me mbulim tokësor lokal/regjional që operojnë në regjionin në të cilin janë mbajtur zgjedhjet si dhe OSHMA-të për të cilat KPM ka pasur të dhëna se do të mbulojnë fushatën zgjedhore, RTK2, TV PULS dhe TV KISS.

Lidhur me vlerësimin e pajtueshmërisë për të licencuarit tjerë, KPM ka vendosur që të monitorohen në bazë të ankesave të parashtruara nga palët.

Me qëllim të veprimit në pajtueshmëri të të licencuarve të KPM-së me Ligjin për Zgjedhje, KPM konsideron se janë të domosdoshme takimet paraprake me OSHMA-të si dhe komunikimet e vazhdueshme me to veçmas në gjatë periudhave të fushatave zgjedhore. Për të mundur kryerjen e suksesshme të aktiviteteve të këtyre, KPM e konsideron të domosdoshme sigurimin e resurseve të nevojshme, buxhet shtesë në çdo vit zgjedhor i cili do t'i mundësojë:

- angazhimin e stafit shtesë dhe përgatitjen/trajnimin e tyre për monitorimin e OSHMA-ve gjatë fushatave zgjedhore;
- realizimin e aktiviteteve përgatitore para fillimit të fushatave zgjedhore;
- organizimin e takimeve dhe debateve me përfaqësues të OSHMA-ve dhe palëve tjera të interesit, me qëllim të qartësisimit të të gjitha dilemave që lidhen me mbulimin e fushatës zgjedhore (përfshirë këtu edhe ndarjen e rolit të KPM-së nga institucionet tjera përgjegjëse për procesin zgjedhor;
- Realizimin më gjithëpërfshirës së monitorimit të përmbajtjeve gjatë fushatave zgjedhore.

X. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në bazë të të dhënave të gjetura nga monitorimi i periudhës zgjedhore, KPM konkludon se:

- OSHMA-të kanë raportuar kryesisht në mënyrë korrekte, në pajtueshmëri me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje si dhe Kodin e Etikës për OSHMA-të, me përjashtim të disa subjekteve të monitoruara.
- Nuk i është kushtuar rëndësi e madhe mbulimit të aktiviteteve të kësaj fushate zgjedhore, kjo për faktin e hapësirës/sasisë së vogël të dhënë në programin e tyre gjatë periudhës monitoruese. Edhe pse aktiviteti i zgjedhjeve lokale është i një rëndësie të lartë për qytetarët dhe qeverisjen lokale.
- Ashtu si edhe gjatë periudhave zgjedhore të mëparshme, është vërejtur se OSHMA-të që transmetojnë në gjuhën shqipe mbulojnë kryesisht aktivitete të SCP-ve nga radhët e komunitetit shumicë në vend, ndërsa ato që transmetojnë në gjuhë të komuniteteve, në këtë rast në gjuhën serbe, mbulojnë vetëm aktivitete zgjedhore të SCP-ve nga radhët e komunitetit serb. Ky është parë si një tregues se OSHMA-të janë të prirura të ofrojnë përmbajtje programore në mënyrë selektive për kategori të caktuara shoqërore, edhe në baza të përkatësisë etnike.
- Gjatë fushatave zgjedhore, në raste të caktuara vërehet se ka përmbajtje me elemente të gjuhës së urrejtjes si dhe përmbajtje dhe përdorim të shprehjeve që cenojnë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin e vendit.
- Në periudhën e heshtjes zgjedhore, përkatësisht gjatë ditës së votimit, një nga OSHMA-të ka mbuluar aktivitete të cilat kanë rënë ndesh me heshtjen zgjedhore.

Në bazë të të gjeturave nga monitorimi i periudhës zgjedhore, të prezantuara më lartë, KPM rekomandon që OSHMA-të duhet që të:

- Veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet, si dhe Udhëzuesit e KPM-së lidhur me zgjedhjet, përfshirë edhe legjislacionin në fuqi, në veçanti në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale;
- Gjuha e përdorur gjatë fushatave zgjedhore duhet në jetë në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale, duke respektuar parimet etike, mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të njeriut, si dhe të mos përmbajë gjuhë të dëmshme, fyese, denigruese dhe gjuhë të urrejtjes apo materiale që mund të nxisin dhunë, diskriminojnë apo njollosin individ apo grupe të caktuar të shoqërisë;
- Jenë të vëmendshëm se janë përgjegjës për çdo përmbajtje të transmetuar përmes tyre, duke përfshirë këtu edhe ritransmetimin e përmbajtjeve nga subjekte tjera transmetuese;

- Ndërmarrin veprime të duhura për evitimin e përdorimit të gjuhës së papërshtatshme, denigruese, ofenduese dhe gjuhës së urrejtjes në rastet kur ndodhin në programe të drejtpërdrejta;
- Të ofrojnë informacion dhe hapësirë të balancuar dhe të barabartë për të gjithë SCP-të e përfshira në garën zgjedhore;
- Jenë më të vëmendshëm gjatë mbulimit të periudhës së heshtjes zgjedhore, veçmas gjatë transmetimeve apo ritransmetimeve të drejtpërdrejta të përmbajtjeve programore, ku ekziston mundësia e keqpërdorimit të hapësirës së ofruar qoftë nga kandidatët, qytetarët e intervistuar, për të bërë thirrje apo promovim për ndonjë SCP të caktuar, gjë që mund të ndikojnë në procesin zgjedhor;
- Jenë më të vëmendshëm gjatë mbulimit të periudhës së heshtjes zgjedhore, veçmas zgjedhjes së pamjeve përcjellëse të kronikave, në mënyrë që të evitohen pamje që mund të përmbajnë material që i takon aktivitetit zgjedhor, si logo/simbole dhe flamuj partiak, moto të fushatës së tyre, numrit garues apo ndonjë detaj tjetër;
- Gjatë raportimit, të kenë parasysh që në periudhën e heshtjes zgjedhore, institucioni i vetëm zyrtar për informim lidhur me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, parregullsitë dhe keqpërdorimet e mundshme në vendvotimeve është Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ).

Monitorimi është kryer në bazë të obligimit ligjor të përcaktuar në Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, që vlen edhe për Zgjedhjet Lokale, nga Departamenti i Monitorimit dhe Analizave i KPM-së.